

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kërcënimet ruse dhe kineze, 12 vende evropiane kërkojnë që BE-ja të forcojë praninë në Arktik
ADRESA	https://tpz.al/kercenimet-ruse-dhe-kineze-12-vende-evropiane-kerkojne-qe-be-ja-te-forcoj-e-pranine-ne-arktik-i332937
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:49:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:43:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2e306a14dea9434fa7c6fa6e7679ac079508b3ff6ae064dcfa4ea793b0066cb1
TEKSTI	f0a9c82637b1424b10d0a7ac4759dca2f81c23f35d09c86c88ceb59ff479e299
PAMJA	55d575fe31a7d836558bec655c14b1c248ff815984653d4defbc115dd564f53e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2eac42584a4935f3524eabf51afb75c60c581bbd6b8c8bb4b0bb3a143aa39ba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	49912a82e108233a2f4c1eb29c0feee4310e444550233db1ec41850f1c69f554
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2eac42584a4935f3524eabf51afb75c60c581bbd6b8c8bb4b0bb3a143aa39ba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

20:03 Nis protesta e 107-të para Kryeministritë, protestuesit thirrje kundër klasës politike • 19:47 Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin dhe i

BOTA, 14 SEPTEMBER 2026, 21:43

Kërcënimet ruse dhe kineze, 12 vende evropiane kërkojnë që BE-ja të forcojë praninë në Arktik

tpz.al TPZ



Dymbëdhjetë vende evropiane i kanë bërë thirrje Bashkimit Evropian të rrisë praninë e tij në Arktik dhe të luajë një rol më strategjik në një rajon që po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një pikë të nxehtë të përplasjes gjeopolitike.

Në një deklaratë të përbashkët pas Samitit Evropian për Arktikun, të zhvilluar në Rovaniemi të Finlandës, vendet kërkuar që BE-ja të marrë një rol "më strategjik dhe proaktiv në Arktikun evropian", në një kohë kur Rusia po shton aktivitetin ushtarak dhe Kina po zgjeron interesin e saj në këtë zonë.

Në samit morën pjesë, mes të tjerëve, kancelari gjerman Friedrich Merz, kryeministria daneze Mette Frederiksen dhe ministri i Jashtëm francez Jean-Noël Barrot, transmeton Telegrafi.

Shefja e diplomacisë së BE-së, Kaja Kallas, tha se Bashkimi Evropian duhet të qëndrojë "vigjilent" përballë rritjes së aktivitetit ushtarak të Rusisë në Arktik, por edhe interesit në rritje të Kinës për rajonin.

Kallas bëri të ditur se BE-ja do të prezantojë në tetor një strategji të re për Arktikun, në të cilën siguria do të jetë në qendër.

"Është e qartë se kjo është pjesë e arkitekturës së sigurisë së Evropës", deklaroi Kallas.

Arktiku ka një rëndësi të veçantë strategjike, pasi shërben si një korridor që lidh Amerikën e Veriut me Evropën, duke përfshirë rrugë të rëndësishme transporti, komunikimi dhe tregtie.

Por ndryshimet klimatike dhe pasuritë natyrore të rajonit, së bashku me pozicionin e tij gjeografik, e kanë kthyer atë në një terren gjithnjë e më të rëndësishëm për konkurrencën strategjike mes fuqive të mëdha.

Sipas NATO-s, Moska ka rritur "ndjeshëm" aktivitetin e saj ushtarak në Arktik, duke krijuar një Komandë të re Arktike, hapur objekte ushtarake dhe testuar sisteme të reja armësh.

Edhe Kina ka interesa të rëndësishme në rajon, veçanërisht për shkak të qasjes në minerale

ide!

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternative

Nga Preç Zogaj

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?


Nga Thoma Gëllçi

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

kritike, burime energjetike dhe linja të reja komunikimi.

[Shiko të tjera video](#)

Kjo situatë ka shtyrë vendet evropiane të kërkojnë një angazhim më të madh të BE-së në një zonë që tradicionalisht ka qenë e dominuar nga interesat strategjike të fuqive të mëdha.

Samiti në Rovaniemi u zhvillua në një kohë kur Grenlanda është bërë një tjetër pikë e rëndësishme e debatit për sigurinë në Arktik.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, vizitoi Grenlandën në fillim të këtij muaji, ndërsa BE-ja ka sinjalizuar mbështetje të vazhdueshme për ishullin autonom danez, pas deklaratave të përsëritura të presidentit amerikan Donald Trump për marrjen nën kontroll të tij.

Brukseli ka tentuar t'i përgjigjet kësaj qasjeje duke premtuar rritje të investimeve në Groenlandë. Gjatë vizitës së saj, von der Leyen njoftoi një partneritet prej 200 milionë eurosh me territorin autonom danez, fonde që pritet të investohen gjatë këtij dhe vitit të ardhshëm.

Trump ka argumentuar vazhdimisht se SHBA-ja duhet të marrë kontrollin e Groenlandës për arsye të "sigurisë kombëtare", duke paralajmëruar se në të kundërt Rusia ose Kina mund ta marrin nën kontroll ishullin.

Qasja e presidentit amerikan ka shkaktuar kundërshtime në Evropë dhe ka nxitur diskutime të reja mbi sigurinë e Arktikut dhe rolin e Evropës në këtë hapësirë strategjike.

Rëndësia e Grenlandës për sigurinë amerikane nuk është e re. Në kulmin e Luftës së Ftohtë, SHBA-ja raportohet se kishte 17 objekte ushtarake dhe më shumë se 10 mijë trupa në ishull.

Sot, SHBA-ja operon vetëm një bazë, Pituffik Space Base, e cila është instalimi më verior i Departamentit amerikan të Mbrojtjes.

Baza përdoret për paralajmërim dhe mbrojtje kundër raketave, si dhe për misione të mbikëqyrjes hapësinore, duke e bërë Grenlandën një pikë kyçe në arkitekturën e sigurisë së Amerikës së Veriut dhe Evropës.

BOTA / 14 September 2026, 21:04

Gjermania urdhëron ushtarët të shërbejnë në Lituani për shkak të mungesës së vullnetarëve

BOTA / 14 September 2026, 20:25

Rrëzohet avioni në Gjermani, 3 të vdekur

BOTA / 14 September 2026, 20:10

Zelensky pezullon prokurorin e përgjithshëm, ai akuzon nga arratia drejtorin e

BOTA / 14 September 2026, 19:00

Kontrollet e reja kufitare në BE, 9 shtete shtojnë zbatimin e plotë të sistemit biometrik

antikorrupsionit për falsifikime

BOTA / 14 September 2026, 17:44

Kanadaja hyn në lojë,
Zelensky zbulon paketën e re
të armëve për Ukrainën

BOTA / 14 September 2026, 17:40

Përplasje në BE për
sanksionet ndaj Rusisë,
Sllovakia kërkon ndryshime

BOTA / 14 September 2026, 17:24

Treni pranë kufirit u sulmua, a
është ky një paralajmërim për
Europën?

BOTA / 14 September 2026, 16:39

Irani zgjeron "listën e zezë" të
anijeve në Ngushticën e
Hormuzit, kërcënon me gjoba
dhe konfiskime

BOTA / 14 September 2026, 14:53

Trump: Do nxjerr "sekretet" e
11 shtatorit/ Presidenti
amerikan, premtim familjeve
të viktimave

BOTA / 14 September 2026, 14:20

Bill Clinton tregon pse CIA i
tha të mos e vrisnin Bin
Ladenin para 11 Shtatorit

BOTA / 14 September 2026, 14:13

Rritja e çmimit të naftës,
Trump gjen 'fajin' te Ukraina:
Nuk ka ndikuar lufta në Iran

BOTA / 14 September 2026, 10:48

Lufta/ Sulmi ndaj bazës
amerikane me 3 viktime,
Trump hedh poshtë raportin
se Kina i ka dhënë

informacione te inteligjences
Iranit

BOTA / 13 September 2026, 21:43

Opozita e qendrës së majtë kryeson zgjedhjet parlamentare në Suedi, e djathta ekstreme humbet terren

BOTA / 13 September 2026, 21:39

Zelensky vendos sanksione ndaj ish-zëdhënëses së tij Yuliia Mendel

BOTA / 13 September 2026, 21:11

Trump rikthen debatin për bashkimin e Irlandës: Do të ishte e natyrshme të bashkoheshin Veriu dhe Jugu

BOTA / 13 September 2026, 19:58

Pas tensioneve me SHBA-në, Kanada po shqyrton statusin e "anëtarit të asociuar" në BE

BOTA / 13 September 2026, 19:56

Droni rus godet trenin pranë kufirit polak, pak minuta pas kalimit të ish-kryeministrit Boris Johnson

BOTA / 13 September 2026, 18:54

Austria ndalon shaminë për vajzat nën 14 vjeç, shpërthen debati për lirinë fetare

BOTA / 13 September 2026, 18:53

Trump akuzon Zelenskyn për sulmet ndaj depove ruse të

BOTA / 13 September 2026, 18:06

27-vjeçarja hidhet nga kati i 15-të i pallatit, bie sipër

[Karburantit: Po e demton](#) [karroces me remije](#)
[botën, ndiq qëllimet e tua, jo](#)
[naftën](#)

[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#) [NJOFTIME NGA TPZ.AL](#) 

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja
jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në
shërbim të interesit publik.

AKTUALITET **SPORT**
IDE **TEJ E KETEJ**
NË FOKUS **BLOG**
BALLKAN **EMISIONE**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.